

83H-1.

R 91



# JAM ELEKTRİÇİST

LLAMBRO RUCI

891983-1

R 91

5

LLAMBRO G. RUCI


# JAM ELEKTRİÇİST

- POEZI -

14855

~~44654~~

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»



## JAM ELEKTRİÇİST

1.

Mëngjezi me trastë mbi shpinë  
Më gjeti në rrugë dhe më tha:


— Ditën e mirë!  
Unë rend vetmitar,  
Çapkën si një herë,  
Veç pikat e shiut  
shkasin në fytyrë...

2.

Dua të ikij  
Me linjën e tensionit të lartë.  
S'ka gjë se rruga ësht' e gjatë.  
Se mes fijesh tensioni  
Është thurur jeta ime,  
Ëndra ime...

3.

Dhe ja arrij  
mes shokëve të mi...  
Është e bukur jeta  
mes tyre.  
Ditët  
Nisen me trokun e turbinave  
Dhe ngjiten  
majë shtyllave.  
Ndofta kërkojnë  
melodi për këngët,  
Për këngët e duarve  
për këngët e punës.



## TY RINI KANTIERESH, TË KËNDÖJ!

Sot

Mbi gjurmët e tua,  
Rini kantieresh, u përkula.

Mbi gjurmët që le pas  
Duke pérshkuar

kilometra më këmbë,  
Duke lagur baltën me djersë.

Qeshu, rini e kantierit!

Gazin e shpirtit  
derdhe mbi gurë e beton!

Me vrullin e duarve të brumosura me punë  
Ktheji lumenjtë

Në shtretërit e rinj  
përgjithmonë,

Që vala e tyre të qeshet në turbina.



## KËNGË KANTIERESH

### I

Kësaj kënge  
Vendlindjen as unë s'ja njoh.  
Vetëm di se brodhi ndër kantiere,  
Herë pas here,  
Që këmbët mes baltës t'i çmpinte  
Dhe ujë me grushte  
Lumenjve të pinte.

Ti erdhe me libra ngarkuar  
Në dhomën tonë —  
Një barangë me letër katrama mbuluar,  
Ku era fërshëllente,  
Dhe shiu këndonte  
Për jetën e gjallë të kantierit.

Ne të shikuam...  
Ne kërkonim në sytë e tu të menduar  
Shokun tonë.  
Kishim dëgjuar...  
Se inxhinierët mbajnë kokën lart.  
Sy më sy vështruam njëri-tjetrin:  
«Ku na e prunë këtë?!»  
S'dinim shumë gjéra.  
S'dinim si bëhej kuvendimi  
Me kabllot shumëfishe elektrike.  
Në skica e projekte s'ulej as më trimi.  
Ato na kallnin tmerr e frikë.  
Shumë ngadalë zinin vend në kokën tonë  
Ligjet...  
Vetëm ti buzëqeshje si gjithmonë  
Kur dikush s'dinte të përgjigjej.  
Dhe nisje prapë  
Me zë të shtruar:  
C'kish thënë Ohmi  
E Lenci ç'kishte shkruar...  
Megjithatë  
Ne ndruheshim nga ti,  
Gjersa një ditë  
Në shpirtin tënd shikuam  
Të tillë bukuri,  
Sa t'adhuruam jo, si dikur, si perëndi,  
Por thjesht: si një Njeri!

Era frynte,  
 Fort tē shkundte  
 Dhe tē thoshte: prapa ktheu!  
 Shih rrufenë  
 Që mëdysh horizontin theu.  
 Dëgjo shiun që çirret, hata!  
 Si papagall, mbi mushama:  
**Ktheu... ktheu... ktheu...**

*Por ti ikje.*  
**Ikje më këmbë**  
 Dhe s'të shkonte nëpër mend  
 Që tē ktheheshe,  
*Pas tē mbeteshe.*  
**Mushamanë**  
 Lë mënjanë  
 Dhe nxiton, vrapon  
 Më shumë.  
 — Le tē bjerë shiu me shtëmbë!

Ja tuneli —  
 Djersa jonë.  
 Gjith'me ujë vithisur ngeli.  
 — Duhet futur!  
 Motopompat në punë  
 Sa më parë duhen vënë!

Me gjith' rroba  
 Ti u hodhe.  
 As u trembe  
 As mendove  
 Se ç'të priste.

Veç me mendje pëshpërisje:  
— Motopompat, motopompat...  
Dhe, kur dole,  
Buzëqeshje si gjithmonë.  
Ti nuk prisje  
Sipër duarsh të barisje.  
Veç kërkoje posht' të zbrisje.  
Një cigare me ne të ndizje.



## UDHËT E RINISË . . .

### I

1.

Një varg i gjatë  
Vullnetarësh,  
                              buzëqeshjesh,  
                              kazmash  
Janë rrjeshtuar  
Përbri trasesë së piketuar . . .

Dhe heronjtë  
Janë futur në radhë...  
Ja Migjeni, tek thur,  
Më këmbë,  
Një këngë  
                      të re  
Për Rininë,  
Për «vocrrakët e rinj»  
Që pash më pash  
                      përshkojnë Shqipërinë.

2.

Margarita  
                      tund shallin-aksioniste  
Me vrullin e demostratave  
                      antifashiste.  
Ka ardhur të qëndisë  
Si atëhere, mbrëmjeve,  
Shamitë e kuqe partizane.  
Ngrihet  
E gjallë,  
                      e qeshur,  
                      gazmore  
Dhe mer rrugën në këmbë.  
Nën këmishë  
Fshihen plagët e hetimeve,  
                      që qepi heshtja.  
Sot po ta shihnin armiqtë,  
Nëpër dhëmbë,  
                      shpirti do t'u dilte...

## II

### 3.

Vullnetarët e parë  
u nisën me një torbë në sup,  
Ku kishin futur  
Dy gishtrinj bukë,  
fishekët, vullnetin,  
Shtrëngonin fort në duar  
Lapsin — për të mësuar historinë e Partisë,  
Kazmën — për të çelur shtigjet e së arthmes.  
Pushkën — për të mbrojtur Republikën  
dhe historinë e Partisë.

### 4.

Kështu filloi poema e 2.500-ve  
Kështu u shkruan qindra poema  
Natën, nën dritën e zjarreve-pishtarë,  
Mes trokitjeve të shiut  
Mbrëmjes, Rini, dhe èrës në janar.

Kontrolloje pushkën,  
futje krehrin me fishekë  
Dhe ikje shtigjeve  
përpjetë  
Të ndiqje hijet  
Që bridhnin rrrotull rrugës sate.

### III

5.

Hekurudhë e R.P.SH.!  
A e mban mend  
çapin e parë,  
Kur  
si mijëra fishekzjarrë  
U ngritën duart e Rinisë  
në përshëndetje?  
Kur hark triumfi  
u bënë  
shamitë e kuqe partizane?

6.

Nesër  
Lokomotivat radhë-radhë  
Do të vrapojnë  
mbi binarë...  
Do të rendin fushave  
me valle e këngë,  
në cdo vend.  
Dhe ti, Rini,  
Do të shpalosësh  
shallet e aksioneve të tjera të reja.

Do tē buzëqeshësh  
për duart e tua  
pa flluska tē kuqe.  
Dhe tē tjerë poetë  
Nga gjiri yt  
për jetë  
Do tē këndoijnë:  
— Qeshu, qeshu, Rini!

## HYJ NË RADHËT E VULLNETARËVE

Brezi im — Rini —  
Ballëlartë,  
Sulmo katalogët e normave ti!  
Me shikimin tënd-teh kazme, —  
Me duart e tua,  
Vulosur me kallot e aksioneve,  
Vërvitu mbi togjet e dheut,  
Mbi mykun e zakoneve,  
Thyeju brinjët!  
Dhe ndërto grafikë,  
Jo me shigjeta kuq e blu  
Por me kazm' e lopatë,  
Me duart e tu.

5.

Kam dalë herët në agjensi,  
Jo të sodis ngjyrat e agimeve.  
Shikoj vullnetarët,  
Që ngjiten sipër maqinave  
Dhe ulen mbi valixhe.  
Nesër  
Do të kapërxej spontin e karrocerisë  
E do të ulem dhe unë  
Mbi valixhe,

Duke menduar pér jetën  
Që na fton në zjarrin e provës,  
Ku kaliten zemrat,  
Ku vrullet shpérthejnë si mijëra lule  
Në mëngjesin e parë pranveror.

6.

Ndonëse zhurmojnë skapamentot e maqinave,  
Këngën e vullnetarëve  
S'e mbulojnë dot.  
Kjo këngë —  
Këmbanë mëngjesi —  
Do të ushtojë pér jetë e mot  
Rrugëve,  
Duke detyruar jetën  
Të kapërxejë fletët e kalendarëve-vitet  
Me një hap tjetër.

7.

Kur maqinat në asfalt fluturuan...  
M'u duk  
Sikur me vete muarën  
Një pjesë të atmosferës...  
Pas dy muajve përsëri  
Këtu në agjensi  
Do të vihen në radhë  
Të tjerë vullnetarë...  
Dhe unë  
Me vëllimin e kuq të poezive  
Do të kapërxej spontin e karrocerisë...



MIRËMËNGJEZI  
ZONJA ÇURRE!

Mirëmëngjezi, Zonjë!  
Me trokitjen e hapave të tu ushtarakë  
Erdha të të fal pëershëndetjen e parë.  
Me vete kam marrë  
Frymëmarrjen e erës,

44654  
14816  
17

SALOJEN E SHTRY

Fëshfërimën e pyjeve të Labërisë,  
Blegërimën e qengjave, tek lëpijnë gar-  
dhin,  
Si një melodi gazmore.

Mendimet t'u poqën para kohe  
Në furrnaltën e hallevë.  
Duke shtrënguar në gji  
Fjalën P A R T I,  
U hodhe kundër dallgëve  
Që vinin rrrotull maleve...

Eh, sa gjëra mësuat ju atëhere  
Duke ikur shtigjeve të dhive,  
Duke ndenjur pa gjumë,  
Duke folur në gjysm' errësirën e shtëpive  
Me fshatarin  
Që trazonte hirin e vatrës me fjalët e tij.  
Erdha, Zonjë, të marr buzëqeshjen tënde,  
Të ndezim bashkë llambat mbrëmjeve,  
Me trokitjen e këpucëve të tua ushtarake  
Të bëj roje piramidave!




## VJERSHË PËR PERSEFONI KOKDHIMËN

I lashtë,  
si mbrëmja,  
më duket ky rrap,  
Ku sonte vij  
me shamizezat nëna  
himarjote...  
Bredhim midis gurëve,  
rrugicave,  
rrugëve.

Kérkojmë hapat e tua  
tek vraponin  
portë më portë,  
Tek ndanje trakte —  
fletëhyrje  
për të komunizmit botë.

Dëgjo Persefoni...  
Xhelati po vjen  
Duke fshikulluar me këmbë  
Ajin e koridorit — plumb të rëndë.  
Dëgjo... hat shuhën,  
Kënga e shokëvë  
Qeli më qeli rritet.  
Dielli i nëntorit skuq  
E majave ngrihet.  
— Vellezër,  
A munden vallë qindra, mijra xhelatë,  
Të çojnë në trekëmbësh këtë diell-flamur,  
Këtë diell-gjak?  
Prandaj buzëqeshte

E dinte:  
Ne shtrëngonim grushtet e hakmarjes  
mbi sofër çdo darkë,  
Ne s'flnim.



## IM ATË DHE YJTË PARTIZANË

Në një kasolle,  
Ku mes kujtimesh  
Nanuriset fëminia,  
Ku vitet  
vinin gjyslykët  
Për të kërkuar  
Pjesën e humbur të gëzimit...  
Atje linde, im atë!  
Dhe të pritën me heshtjen e zakonshme  
Që shtrohet në vratat e varfëra,  
Kur shtohet një gojë më tepër,  
Një mendim më shumë,  
Dy duar që shtrihen dhe presin.

Koha t'i kaliti gjymtyrët.

Im atë.

Të duheshin gjymtyrë të gjatë  
Kishe mbi shpinë

Një thes të mbushur me lot,

Një thes të mbushur me èndrra  
(Vetëm dy gishtrinj bukë!)

Dhe ti ecje,

Vrapoje.

Një rrugë, i kërrusur, shënoje

Për ne dhe për ata që do të vinin pas...

Por mijëra yj partizanë,

Tek ulën kokën pér të kaluar

Prakun e kasolles,


Bashkë me buzëqeshjen e parë,

Thanë:

— Nesër do të marrim një rrugë tjetër

Pa vaj e lot,

Pa këmbë të zbathura, shokë!



## SHTËPIA E RE

1.

Anës rrugës

një shtëpi e rrënuar  
nga kohërat,

Ka ngelur

ashtu, ballékthyer  
nga kodrat.

Shikoj gurët,

që janë rrëzuar  
mënjanë

Dhe mendoj për ata

që, dikur, cicëruan  
e vanë...

2.

Në gjoksin e shtëpisë  
nxijnë akoma  
hijet e gjyleve.  
Të zeza hijet,  
të rënda gjylet  
me hundën drejt pyjeve...  
Nga erdhët  
Ju, gjyle,  
që këtu ngulët  
shkopinjt' e vdekjes?  
Cila dorë  
Nuk u drodh  
dhe këtë vatër  
mori në shënjestër?

3.

Fshatarët  
vinë e mbartin  
gurët e rrëzuar,  
Më tej themelet kanë hapur,  
një shtëpi të re  
për të lartuar,

4.

Asnjë dorë s'do guxojë  
të marrë këtë shtëpi  
në nishan  
Ku syqeshur  
do të lozin  
fëmijët tanë.

## GJONI KAPEDAN...

1.

Galera-pul' bardhë  
Natën detin çan.  
Te timoni rri  
Gjoni kapedan...

Mblidhen himarjotët,  
Zbresin në liman  
Të presin galerën,  
Gjonin kapedan.

Bashkë me mëngjesin  
Malet buzëqeshin.  
— Erdhi prijsi ynë:  
Trimat shpatat zhveshin.

Në malet e mbrojtur  
Nga shpata dhe pushka  
U ngrit shkab' e zezë,  
Krisi egër lufta...

2.

Në sheshin e vdekjes,  
Vajzat kapedane,  
Dalin radhë-radhe  
Të dredhin një valle...

Mandilet e kuqe  
Ç'i mbajnë në dorë.  
S'i kan' më të bardha,  
Të bardha si borë.

Se i skuqën sot  
Në plagët e trimave,  
Që s'u ndruhen, jo,  
As dhe vetëtimave.

3.

Një kalorës ikën.  
Në mesin e natës...  
Shtigjeve vrapon  
Zgalem i shtrëngatës.

Malet njëri-tjetrit  
Lajmin i dërgojnë.  
— Armët fort shtrëngoni,  
Turqit po afrojnë!

Se ç'u la ky vend  
Çdo pëllëmb' e gjak,  
S'mposhtet Arbëria  
Qoftë në tym e flakë.

4.

Prijsin sypatrembur,  
Gjonin kapedan,  
E kujtojnë dendur,  
Dendur këto anë.

Gjith' sultaniët bashkë  
«Xhindët» himarjotë,  
S'i përkulen, jo,  
S'i çfarosën dot.

Përmbi malet — çerdhe  
Ngrihej shkabë e zezë,  
Trimërinë e vjetër  
Në zemra të ndezë.

## UDHÈ E MBARÈ!...

## *Fragment*

... Mëngjezi vjen  
me kominoshe  
në uzinë.  
Motorët shkunden  
e frymë marrin  
me gëzim.  
Detalet radhë-radhë rrjeshtohen,  
nisen...  
Udhë e mbarë detaleve  
me gjurmata duarve  
të shoqeve!  
Rojtari plak  
kasketën tund,  
kur portën u mbyll e u hap  
Maqinave,  
detaleve, që ikin udhëve,  
larg...



## NËNA IME, NËNAT.

Si mijëra nëna në atdhe  
Je ti e shtrënja nëna ime.  
Ty dhe atyre sonte u jap  
Përshëndetjet e djemve — këngën time.

Me çapin e plakur ülesh në prak  
Fotografitë mban në duar e menduar...  
— C'bën vall' im bir atje lark?  
A flë si dikur pa jorgan,  
Mos gjer vonë mbi libra rri zgjuar?

Moj nën' e thinjur udhëve, mendimeve  
Më prit mua sonte tek der' e avllisë.  
Dhe po nuk erdha  
Mallin tim — këto vargje  
Me fijet e dritës do t'i nis.

## KOKËN LART, NËNAT DHE MOTRAT E MIA!

1.

Burrat

Ndiqnin rrathët e tymit  
mejhaneve.

Duke pirë,

Ahet e hallevë,

Që dilnin nga fundi i zemrave,

Mirrnin formën e zakonshme

Të pëllëmbëve,

Shqelmeve.

Heshtnin nënët,

Duronin,

Rrëmbenin në prehër fëmijën

dhe qanin.

2.

Kështu lindnin vajzat

Siç mbijnë lulet  
maje shkëmbit të egër.

Koha i vadiste,

i rriste

Pa dorën e butë të përkëdheljeve.

3.

Pastaj shkonin nuse.

Shkonin me një tufë ëndrash

si mëngjezi.

Por sic binte

**ditën e dasmës**

orizi breshér.

Si rridhnin meloditë e këngët,

Ashtu tē nesérmen shpérthenin

Breshëritë e sharjeve të rrugës.

4.

Dheu plasaritej,

thyhej

pér një pikë ujë,

Ashtu thyheshin atëhere zemrat

Për një fjale të mirë,

Për një buzëqeshje.

5.

U foli nënave,

vajzave koküllura

me syt' e mbuluar:

Çojeni kokën lart,

三三〇

Nënët dhe motrat e mia!

— Erdh koha  
Në zjarr' e flakë  
Të përvëlojmë botën e vjetër,  
Tha PARTIA.

6.

7.

Sot  
Para mbledhjes popullore  
gjunjëzohen paragjykimet.  
Dheun rrakin me këmbë.  
Harruan ato  
që nënët  
shekuj me rradhë  
Dhëmbjet përtypnin nëpër dhëmbë.  
Zër' i masës —  
Diktaturë e proletariatit  
paragjykimet  
godet e shqelmon,  
I detyron para mikrofonit.

Zëdridhur  
Për krimë të përgjigjen.

8.

Nuk shtrydhen më — sfungjer  
me lotë —  
19 vjeçaret  
Xhemiletë, Naziretë.  
Pranverat në supet e tyre  
do të hedhin  
trëndafila,  
Pranverat e revolucionit  
Me këngë,  
buzëqeshje  
dhe ëndra.

9.

Çojeni kokën lart,  
Nënët dhe motrat e mia!  
Në zjarr e flakë,  
Të përvëlojmë  
Botën e vjetër,  
Tha P A R T I A.

## SIVJET PRANVERA S'NA DËRGOI LAJMËS LULET E BAJAMEVE.

Sivjet pranvera  
erdhë më herët,  
Me më shumë lule  
e ëndra,  
më e freskët.

Mendimet  
si katarakte shpërthyen  
E me dorën e hekurtë  
rrëmbyen,  
flakën:

Gjurmat e tërkuzave supeve të njomë;  
Supeve, që me te u plaken;  
Gjithçka;

gjith' ata  
që duan  
Revolucionet — udhë  
të shuajnë.

Një mbrëmje  
nuk u ul më vajza fshatare  
me gjergjef e gjëlpërë,  
Por mori rrugën  
ballëpërpjetë

Dhe erdhë  
Në zyrën e sekretarit të Partisë.

Vajza flet...

Një monolog i gjatë

Ulet këmbëkryq mbi tavolinë.

Një bot' e tërë

Endur me gjergjef e gjëlpërë

Hidhet në koshin e vjetërsirave.

Babai në darkë

Mendimet në tespixe mbledh,

këput,

me vetullat çark.

Diç kërkon

mes flakëve të zjarrit

në oxhak...

Dje ish e thjeshtë:

Kjo pushkë e varur

njeriun si një fletë

e shtrinte buzë kanalit.

Por sot

Themelet e heshtjes

u shkundën,

ranë.

Syulurat vajza

ngritën ballin përpjetë

e thanë:

— Mjaft më

me tërkuzën në sup,

me lëmshin e dhëmbjeve në fyt!

Sivjet pranvera

s'na dërgoi lajmës

lulet e bajameve,

Por «Fjalimin e 6 shkurtit»,

që kaloi dorë më dorë — fanar  
në anë të anëve.

## ELEKTRİCİSTET

*Elektriçisteve të nënstacionit  
të Sarandës.*

### I

Ato dinin  
Si mbin e shtat hedh gruri fushës,  
Sa bukur është ngrihesh që pa gdhirë,  
Kur flladi fryn e shallin ja heq gushës...

Çelësat, shtyllat  
I kishin parë nga rruga larg e larg...  
Dhe ja, njera-tjetrës diç i thoshin:  
— Çudi si lidhen gjith' k'to gjëra varg!

Një ditë  
Në bankat e shkollës u ulën përsëri.  
Inxhinieri ligjet ndër shënimë uli,  
Eh, sa ligje ka korenti... me Lenc e Zhul...  
Sa halle kanë linjat, që çojnë energji...

Përditë

Rrugës ikin dorë për dorë, dy nga dy.  
Shoqet e turnit venë të këmbejnë.  
Veç libra mbajnë pranë gjithënjë,  
Çudit' e tjera radhë t'i zbërthejnë...

## VĒLLEZĒRVE VIETNAMEZĒ

Nga kaltēroshi  
Jonian,  
Nga pozicionet tonā  
Vij nē pozicionet tuaja,  
Vietnam.  
Vij tē kēndoij  
Me korin e armēve tuaja,  
Armēve tonā:  
— Zjarr!

Majē njē palme  
Dēgjoj  
Kēngēn e njē vajze  
13-vjeçare:  
— Le tē vijnē,  
Mirē se tē vijnē jankitē!  
Zakon i lashtē —  
Me plumba  
Pērshēndeten armiqtē.

Ēshtē e rēndē  
T'u thurēsh vargje, kēngē,  
Atyre qē kanē rēnē...

Mallëngjimi në fyt  
Dorën e dhëmbjes  
Më ka vënë...  
Por është e lehtë,  
Shok,  
T'u shkruash vëllezërve  
Në anë të anëve.  
Atyre  
Që lindjen e diellit  
Kërkojnë  
Me grykat e armëve.

## **TURNI I TRETË**

Jashtë çmëndurisht hedh valle era  
Dhe unë  
Bashkë me të kam turnin e tretë...

Turni i tretë  
Nuk është hap i zakonshëm,  
monoton —

Ec e jakë  
nëpër sallën e gjatë.


Turni i tretë,  
Jeta jonë me emër:  
Të ecim!

Duke u përleshur netëve me difektet,  
Mes tyre asnijëherë të mos ngecemi!

E dashur  
S'do të ndodhë kurrë  
Që mua t'më rrëzohen qepallat  
në gjumë

Dhe drita të shuhet në dhomën tënde,  
Në mijra dhoma  
ku lexojnë e qeshin njerëzit...

Hidrocentraleve  
Elektricistët ulin duart e fuqishme, mendimet  
Pranë fijeve të gjata, metaleve.



## MBRËMJE NË SARANDË

1.

Dritat — qirinj të përbysur —  
varen përmbi valë.  
Horizontit fanari ndizet e shuhet  
dalngadalë.  
Një varkar i vogël duarve u jep...  
— Hej djalë,  
mirëmbrëma!

## Eshtë e bukur

kjo mbrëmje mbi det.

## Ai buzëqesh

dhe varkën përmbi valë  
nget e nget...

2.

Hëna

varet mbi direkët e anijeve  
peshkatare.

Tutje një këngë u nis,

vrapoi pér nē breg.

E aty në shkumbë,

shkëmbinje ç'u tret.

3.

Eci dhe unë...

## Në kurrizin e mbrëmjes

hapat ngas

Kam një mendim në kokë

dhe dua

ta zb rthej.

Ndaj nisa

veh'tes t'i flas,

Ndaj desha

diç t'i them

së lehtës erë. . .

4.

5.

6.

...Nis e më tregon  
                            peshkatari  
Si u rrit  
                            nëpër dallgë...  
Stinat, vitet  
                            që vinin  
                            e rrrodhën varg.  
Aty e linin,  
                            po aty e gjenin

Duke kerkuar  
me duart miturake  
Detit t'i hiqte  
pér vehten një kafshatë.

7.

E hidhur  
ish kafshata  
nëpér valë.

E nxirë  
udh' e jetës  
pa një shkallë...

8.

Sonte  
ç'më kujtohet  
zëri i gjyshit tim:

— Larg nga deti,  
larg,  
o biri im!

Mos e shih të qetë  
tek hidhet  
lehtë e lehtë.

E midis gurëve  
mërmërit,  
vallzon.

Kur nis e fryhet  
ec' e mbaje  
këtë rrëmet.

Që si vullkan shpërthen,  
në prehër dallgësh  
të rrëmben.

9.

Plaku tund kryet  
duke më dëgjuar...  
— Iku botë e vjetër,  
kohët janë ndryshuar!  
Ky det  
me dallgë e shkumbë  
le të përdridhet.  
S'mendon askush  
më për një kafshatë,  
Që dallgëve të çmëndura  
të hidhet  
nëpër natë.  
Por po u dashka  
si komunisti Adem  
Me gjoks do të çajmë  
çdo shtërngatë  
Kur urdhër jep Atdheu,  
kur bigën, anjen  
deti rrëmben nëpër dallgë.

NDERTONJÉSIT...

1

1.

Tek «Syri i kaltërt»<sup>1)</sup>  
Ballin ul,  
Mendimet të freskoj.  
Shikimin  
Mes valëve blu e ngul...  
— O valë,  
Që duart tonat  
grushte-grushte  
maleve ju mblodhën!

Folmëni  
Për ndërtonjësit, montatorët,  
Që erdhën me valixhen në kurriz ngarkuar  
si ciganët.

2.

Atdheu

Nga tē katér anët

Zgjodhi me duar çelikët e radhëvë...

Dhe ata

Çdo darkë

Mblidheshin në barangën më tē madhe

bashkë

Mbi tavolinë sillnin

Krismat e minave,

dheun e gërmuar,

metrat e betonuar.

Aty kantjeri

Me duart qindra gishtrinjsh

Mat,

korigjon,

hedh shtat.

3.

Kështu

do tē parakalojnë

kantjeret gjithmonë,

Lule,

Që mbinë sot këtu

Nesër

në një vënd tjetër,

diku...

II

4

Bistrica  
I priti me alarme...  
Uji rrjedh,  
Arriti gjer në bel...  
Shoku im minator  
Eja me mua  
pas tingujve të alarmit  
në tunel.

Shiko,  
atje tej  
shoku zalisur ra.

Shpejt në duar të marim shokun tonë.

5.

Rrodhi këngë e vjetër  
për Bistricën.

Një këngë tjetër,  
Këngë e vullneteve të hekurtë  
U ngrit mbi brinjët e malit,  
që nga duar minatorësh  
zbërthehen

Dhe poshtë  
në luginë treten.

6

Gjëmimi i minave heshtि...,  
Tymi u shpërnda,  
                                  u ngjit nëpër re.  
— Hej minator!  
U përqafuan dy tunelet  
                                  Shtrek-Krane.  
Fiksoje në mëndje  
Për jetë këtë moment.  
U duhet pasardhësve  
                                  edhe si legjendë.

7.

Ende  
po dëgjohet akoma  
Kisma e pistoletave  
Dhe e elektrovozit kumbona.  
— Jepi shpejt  
elektrovozist!  
Uji po të ndjek pas...  
Ndalo këtu në Drosla<sup>2</sup>)  
ose më tej.

Dua dhe unë  
pistoletën të rrëmbej,  
Të vij me ty  
tek i fundit injektim,  
Se turbinat presin  
padurim.

### III

8.

10 korrik 1965.

Partia  
mer fjalën në tribunë.

Rreth  
janë lidhur megafonë.

Jemi ne,  
qindra megafonë

Që presim  
fjalën e Partisë.

Është Partia  
që pret fjalën tonë.

Shiriti këputet,  
duartrokositje...

Turbinat  
radhazi lëshohen,  
rrotullohen...

9.

Natë...  
Një hidrocentral i ri  
ju shtua vargut  
të Promethenje

Që, mbërthyer  
majë shkëmbenjve,  
Njëri tjetrit  
i zgjasin dorën.

10.

Barangat u zmontuan.

Ndërtonjësit

në brigjet e Drinit

shtegëtuan.

Përsëri tunele

Alarme të tjerë...

Ndërtonjësi buzëqesh,

ndërsa me flokët e tij  
loz çapkënja erë.

— Buzëqesh,

o montator

i së ardhmes komuniste;

Që shkëmbenjve

e pllakave beton-arme

Gjurmat e gishtrinjve

me zëmrën tënde le!

---

1) Syri i kaltërt — burimi kryesor i ujrave të lumit Bistricë.

2) Drosla — dhomë në dalje të tunelit ku janë valvolat e hapjes dhe mbylljes së ujit.

## PËRMBAJTJA

Faqe

Jam elektriçist .....	3
Ty rini kantjeresh, të këndoј .....	5
Këngë kantjeresh .....	6
Udhët e rinisë .....	10
Hyj në radhët e vullnetarëve .....	15
Mirëmëngjezi, Zonja Çurre .....	17
Vjershë për Persefoni Kokdhimën .....	19
Im atë dhe yjtë partizanë .....	21
Shtëpia e re .....	23
Gjoni kapedan .....	25
Udh' e mbarë.. .	28
Nëna ime, nënënat .....	29
Kokën lart, nënënat dhe motrat e mia .....	31
Sivjet pranvera s'na dërgoi lajmës lulet e bajameve ..	35
Elektriçistet .....	3q
Vëllezërve vietnamezë .....	39
Turni i tretë .....	41
Mbrëmje në Sarandë .....	42
Ndërtonjësit .....	47

Tirazhi 5000 kopje      Format 70j100/32      Stash: 2204-63

Shtyp NISh Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1967